



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E  
PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË  
PARAVE

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 888/1 prot.

Nr. 4937 prot.

(Tiranë, Blv "Dëshmorët e Kombit", nr. 3,  
më 12.2018

Tiranë, Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 15  
më 19.12.2018

MEMORANDUM MIRËKËPTIMI

NDËRMJET

**AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE (AMA)**, si institucion i pavarur, autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**DHE**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE (DPPPP)**, si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit dhe autoritetet e tjera kompetente të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në zbatim të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar.

**DUKE MARRË NË KONSIDERATË**

- ✓ Qëllimin e përbashkët për forcimin e shtetit ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe konkurrencës efektive në treg;
- ✓ Nevojën për një bashkëpunim ndërinstitucional që do të sjellë një kontribut më të efektshëm në këto fusha.

**DUKE JU REFERUAR**

- Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar;
- Ligji 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"

**Palët bien dakord mbi Memorandumin e Mirëkëptimit si më poshtë:**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Marrëveshja ka si qëllim vendosjen e një bashkëpunimi të ndërsjellët, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit jo konfidencial dhe të frytshëm në funksion të veprimtarisë së dy institucioneve.

Bashkëpunimin e dy institucioneve në aktivitete të përbashkëta, në trajnime, seminare, simpoziume, konferenca kombëtare dhe/ose ndërkombëtare të organizuara nga palët.

Bashkëpunimin e dy institucioneve në aktivitete të përbashkëta, në trajnime, seminare, simpoziume, konferenca kombëtare dhe/ose ndërkombëtare të organizuara nga palët.

Përcaktimet e kësaj marrëveshje nuk kanë për qëllim të tejkalojnë parashikimet ligjore mbi bazë dhe për zbatim të të cilave lidhet kjo marrëveshje.

## **Neni 2** **Angazhimet e palëve**

Palët angazhohen që të bashkëpunojnë në respektim dhe zbatim të kërkesave ligjore që burojnë ligjet e sipërcituara dhe në mënyrë të veçantë:

1. Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke akte, literaturë juridike, tipologji, interpretime ligjore apo rregullatore që kanë të bëjnë me fushat e veprimit të dy institucioneve;
2. Të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta, trajnime, seminare, simpoziume dhe konferenca kombëtare dhe/ ose ndërkombëtare të organizuara nga palët për përmirësimin e punës në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga legjislacioni përkatës;
3. Palët bashkëpunojnë për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive në kuadër të aspiratave të Republikës së Shqipërisë për aderim në BE;
4. Palët bashkëpunojnë për shkëmbimin e praktikave, interpretimeve dhe analizave më të mira në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në fushat përkatëse të dy institucioneve.

## **Neni 3** **Detyrimet e Institucioneve**

AMA dhe DPPPP angazhohen që të realizojnë, pikat e mëposhtme:

AMA dhe DPPPP marrin përsipër të përmbushin angazhimet e parashikuara në nenin 2 të këtij “Memorandumi”, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit i cili nuk është i klasifikuar sekret shtetëror për secilën nga palët e saj, por që ndihmon të dy Institucionet në veprimtarinë e tyre, në përmbushje të detyrimeve ligjore, që burojnë nga ligji “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, si dhe nga aktet e tjera ligjore dhe nënligjore respektive.

## **Neni 4** **Komunikimi**

Rregulli i përgjithshëm i shkëmbimit të informacionit është ai shkresor. Gjithsesi, për të rritur efikasitetin, palët do të caktojnë person kontakti që do të jenë përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë dhe i efektshëm.

Në rastet e shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të bien dakord për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet mes palëve.

## **Neni 5** **Personat e Kontaktit**

Pikat e kontaktit për ndjekjen e zbatimit të Memorandumit janë si vijon:

Për DPPPP

**Feim Hoxha**  
(emër/mbiemër)

+355 42 244602  
(tel)

[fhoxha@fint.gov.al](mailto:fhoxha@fint.gov.al)  
(email)

Për Autoritetin e Mediave Audiovizive



**Neni 6  
Ndryshime**

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar me shkrim paraprakisht palën tjetër.

**Neni 7  
Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi nga data e mëposhtë shënuar dhe mund të ndërpritet nga secila Palë, duke njoftuar Palën tjetër paraprakisht në një afat kohor prej një (1) muaji.

U firmos dhe hyn në fuqi me datë 19/12/2018

**Në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të  
Parandalimit të Pastrimit të Parave**

**Arlind GJOKUTA  
Drejtör**



**Në emër të Autoritetit të Mediave  
Audiovizive**

**Gentian SALA  
Kryetar**

